



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.158 dt.21.12.2001

**PER
DHENIE PENSIONI TE POSACËM SHTETROR Z.ALEKO PAPA**

Këshilli Bashkiak i mbledhur më dt.21.12.2001, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Inspektoriatit të Mjedisit Urban, “Për dhënie pensioni të posaçëm shtetror Z.Aleko Papa për arritjen e rezultateve të dallueshme në fushën e shkencës. Mbështetur në Ligjin Nr.8652, dt.31.07.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, si dhe në Ligjin Nr.7703 dt.11.05.1993, neni 5, pika b, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, në VKM Nr.152 dt.05.04.1994, ndryshuar në VKM, Nr.137 dt.20.03.1995 dhe në VKM Nr.1 dt.07.01.1999 “Për kushtet e përfitimit , shumës dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme Shtetore dhe shtesave të pensioneve”

V E N D O S I

1. T’i propozojë Këshillit të Ministrave “Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetror Z.Aleko Papa, për arritjen e rezultateve të dallueshme në fushën e shkencës
2. Shtesa e pensionit të posaçëm të jetë deri në pensionin maksimal, sipas VKM Nr.424, dt.05.09.1994

3. Ngarkohet Drejtoria e Inspektoriatit të Mjedisit Urban (sektori i shëndetit publik) për dërgimin e dokumentacionit përkatës në Këshillin e Ministrave

KRYETARI

Leonidha TOSKA

